



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.240/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit QIF Malta 1 LTD me seli në Republikën e Maltës, përfaqësuar në bazë të prokurës avokati Vigan Rugova nga Prishtina, kundër debitorit Albani SHA me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, KPPP.nr.610/23 të datës 30.11.2023, me datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Albani SHA me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së parë, KPPP.nr.610/2023 i datës 30.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.610/23 të datës 30.11.2023, ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Albani SHA me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër urdhrin për përmbarim P.nr.260/22 datës 30.05.2022, dhe ka lënë në fuqi Urdhrin përmbarimor P.nr.260/2022 dt.30.05.2022, të përmbaruesit privat Rrezarta Metaj në Prishtinë

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i autorizuari i debitorit me arsyetimin se aktvendimi i atakuar është i pabazuar, nuk ka ndonjë arsyetim konkret pa precizar shkaqet. Gjykata e shkallës së parë aktvendimin e ka nxjerr mbi bazën e zbatimit të gabuar të drejtës materiale në dëm të debitorit. Aktvendimit të atakuar i mungojnë faktet vendimtare, i propozon gjykatës që ta aprovoj ankesën e debitorit si të bazuar, të anulohet aktvendimi i ankimuar, të shfuqizohet urdhri përmbarimor P,nr.260/22, dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit

për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori QIF Malta 1 LTD me seli në Republikën e Maltës përfaqësuar në bazë të prokurës avokati Vigan Rugova nga Prishtina, me datë 30.05.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit Albani SHA me seli në Prishtinë, në bazë të titullit përmbartimor - aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, V.Ek.nr.623/16 dt.17.07.2020.

Përmbartuesi privat Rrezarta Metaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.260/2022 të datës 30.05.2022, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbartues - aktgjykimit, duke vlerësuar se dokumenti përmbartues i plotëson kushtet për përmbartim.

Kundër këtij urdhri përmbartimor debitorit ka paraqitur prapësim duke deklaruar se se aktgjykimi nuk është i formës së prerë meqenëse ka ushtruar revizion dhe Gjykata Supreme ende nuk ka vendosur, prandaj aktgjykimi nuk konsiderohet titull ekzekutiv nuk i ka tiparet e përmbartueshmërisë, i propozon gjykatës që të pezullohet kjo procedure përmbartimore deri sa të vendos Gjykata Supreme.

Në përgjigjen në prapësim kreditori kundërshton prapësimin e debitorit dhe i propozon gjykatës që ta refuzoj prapësimin me arsyetimin se revizioni është mjet juridik i jashtëzakonshëm i goditjes se vendimeve dhe nuk e ndalon përmbartimin, ndërsa aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm sipas nenit 166 të LPK.

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.610/23 të datës 30.11.2023, ka refuzuar në tërsi prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se aktgjykimi lëndor është bërë i formës së prerë me date 26.11.2021 dhe i ekzekutueshëm nda data 01.03.2022, në shkresat e lëndës nuk gjendet ndonjë provë e re se aktgjykimi është anuluar nga Gjykata Supreme e Kosovës. Nga dispozita e nenit 22, 23, 24 të LPP-së përmbartimi mund të fillohet në bazë të vendimit të dhënë në procedure gjyqësore nëse bëhet i formës së prerë dhe ka kaluar koha e përmbartjes vullnetare, pra aktgjykimi i formës së prerë i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbartimor dhe për të lejuar përmbartimin e tij.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore, për faktin se në rastin konkret dokumenti përmbartues në bazë të cilit është lejuar përmbartimi është aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i për çështje ekonomike V.Ek.623/16 dt.17.17.2020, i plotfuqishëm nga data 26.11.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 01.03.2022, i cili në rastin konkret është dokument përmbartues, e kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se: *“Dokument përmbartimor është vendimi përmbartues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbartuese”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes se detyrimit”*, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të debitorit, por nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana apo shkaqe për të vendosur ndryshe në këtë çështje përmbartimore, prandaj nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.240/2024 me datë 13.06.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha